



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryetari i Kuvendit

P-130

Prishtinë, më 22 tetor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYETARIT TË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, E MBAJTUR MË 22 TETOR 2013**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, dhe kryetarët e grupeve parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq, Myfera Shinik dhe Goran Marinković.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kjo mbledhje i zhvilloj punimet me këtë:

Rend dite

1. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryetari i Kuvendit i njoftoi kryetarët e grupeve parlamentare për rrjedhën e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 tetor 2013. Ai theksoi se kohëve të fundit po mungon pjesëmarrja e deputetëve në punimet e seancës plenare dhe të komisioneve parlamentare.

Andaj, mbledhja e sotme është ftuar për t'u konsultuar me kryetarët e grupeve parlamentare për vazhdimin e seancës plenare ose shtyrjen e saj deri pas zgjedhjeve lokale, më 3 nëntor 2013. Kryetari kërkoi deklarin e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, tha se mungojnë arsyet për pezullimin e punës së Kuvendit dhe se deputetët e Grupit Parlamentar të LDK-së janë të gatshëm për vazhdimin e punimeve të seancës plenare, pavarësisht angazhimeve në fushatën zgjedhore.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, tha se duhet ruajtur imazhin e Kuvendit. Ai e përkrahu idenë e mosmbajtjes së seancave plenare deri në mbajtjen e zgjedhjeve lokale, më 3 nëntor 2013. Ai theksoi se pajtohet me çfarëdo vendimi që merret për vazhdimin e punimeve të seancës plenare, ose shtyrjen e saj deri pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale më 3 nëntor 2013.

Visar Ymeri, në emër të GP të VV-së, tha se seanca plenare nuk i ka vazhduar punimet, ngase është bojkotuar deputetët e koalicionit qeverisës, me qëllim që ta pengojnë formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së, e jo për shkak të fushatës zgjedhore. Ai deklaroi që nuk ka arsye që të pezullohet puna e Kuvendit deri në përfundimin e fushatës parazgjedhore.

Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, tha se e përkrah propozimin e Ardian Gjinit për mosmbajtjen e seancave plenare deri në fund të zgjedhjeve lokale.

Goran Marinković, në emër të GP të ZB-së, theksoi se nuk ka asgjë kundër vazhdimin të seancës. Mirëpo, pajtohet me mendimin e Ardian Gjinit se duhet ruajtur imazhin e Kuvendit dhe është mirë të mos mbahet seanca deri në mbajtjen e zgjedhjeve lokale, më 3 nëntor 2013.

Pas diskutimeve të lartshënuara, kryetari konstatoi se qëndrimi i shumicës është që Kuvendi të mos mbajë seancë plenare deri në përfundimin e zgjedhjeve lokale më 3 nëntor 2013.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*